



Open
Government
Partnership



Raporti i vetëvlerësimit
PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT
2020-2022

Shtator 2021

Komponenti 1:

Qeverisja e Hapur në Luftën kundër Korrupsionit

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi. Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë. Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese. Prioriteti i qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon dhe me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Trajtimi i korrupsionit është një nga objektivat më të rëndësishëm të qeverisë shqiptare dhe është identifikuar nga Bashkimi Evropian si një nga pesë përparësitë kryesore për vendin drejt integritit në Bashkimin Evropian.

Planet e integritetit dhe pronarët përfitues janë dy objektiva të këtij plani veprimi, dhe që marrin fokus në reformën antikorrupsion për qeverisje të hapur në kuadër të Planit të Veprimit OGP 2020-2022.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*. Qëllimet madhore të politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit në zbatim të saj.

Nismat dhe politikat antikorrupsion mbështesin reformat ndërinstitucionale të nevojshme për funksionimin dhe efikasitetin e përmirësuar të të gjitha institucioneve publike dhe private. Këto iniciativa dhe politika antikorrupsion do të rrisin integritetin, performancën dhe llogaridhënien e institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së përgjegjshme që lehtësojnë zbatimin e barabartë dhe të drejtë të ligjit dhe përmirësojnë shërbimin publik për të gjithë qytetarët, si dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të qytetarëve në çështjet e pronësisë.

Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, udhëheq angazhimin ndërinstitucional për të përmirësuar integritetin publik dhe për të promovuar një kulturë, transparencë dhe llogaridhënie për të gjithë nëpunësit civilë dhe zyrtarët publikë në të gjitha nivelet e qeverisë, por veçanërisht në ato më të prekshmet si dhe të sektorëve të ndjeshëm ndaj korrupsionit.

Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të integritetit për të gjitha institucionet e administratës qendrore dhe institucionet e varësisë së tyre, kërkon vullnet politik thelbësor, kapacitete teknike dhe angazhime brenda këtyre institucioneve. Rezistenca institucionale kundër shkeljeve të integritetit do të duhet të forcohet dhe rritja e transparencës, aksesit i publikut në informacionin zyrtar dhe aktivitetet shtetërore do të kërkojnë angazhim për zhvillimin dhe zbatueshmërinë si dhe raportimin në kohë.

Këto iniciativa janë një shembull shumë i mirë i bashkëpunimit me OSHC-të, të cilat janë bashkë-krijuar me aktorët e interesit në kuadër të Planit OGP 2020-2022. Vlerësimi i riskut të integritetit, takime konsultimi dhe forcim kapacitetes në vlerësimin e riskut, bashkëhartim i planit të integritetit për Ministrinë e Drejtësisë, replikimi i tij në varësitë e MD-së fillimisht dhe në ML-të janë hapa që përmirësojnë luftën kundër korrupsionit, forcojnë integritetin dhe performancën e organeve të administratës si dhe sigurojnë shërbime më të mira për publikun.

Nga ana tjetër, krijimi dhe administrimi i vazhdueshëm i një Regjistri të Pronarëve Përfitues përbën një angazhim thelbësor për parandalimin e korrupsionit përmes transparencës së detyrueshme dhe masave të gjurmueshmërisë.

Referuar dispozitave ligjore në fuqi deri në vitin 2020, subjektet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe të dhënat e tyre, ndër të tjera, lidhur me objektin e aktivitetin dhe gjendjen e ortakërisë, regjistrohen dhe administrohen në Regjistrin Tregtar (QKB) dhe në Regjistrin e Organizatave jofitimprurëse (aktualisht Gjykatë-DPT). Ndërkohë, në rekomandimet e MONEYVAL, u kërkua ndërtimi i një regjistri, në bazë të të cilit të identifikohet dhe të regjistrohet pronari përfitues i subjekteve tregtare dhe organizatave jofitimprurëse, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, ky ligj përmbush një nga detyrat e caktuara nga grupi ndërinstitutional i punës për zbatimin e rekomandimeve të MONEYVAL, të ngritur nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës.

Me anë të këtij ligji, nëpërmjet përkufizimit të pronarit përfitues, caktimit të subjekteve që kanë detyrimin e regjistrimit të tyre pranë regjistrit të krijuar për këtë qëllim, duke përcaktuar njëkohësisht dhe të drejtat e detyrimit të tyre, të institucionit të ngarkuar me regjistrimin e të dhënave dhe administrimin e tyre dhe të institucioneve të tjera që me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore duhet të aksesojnë në të dhënat e regjistruara, synohet të identifikohet pronari përfitues, i cili ka i fundit në pronësi ose ushtron kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik (subjekt tregtar dhe OJF), të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe identifikuar me NUIS/NIPT.

Gjithashtu, me anë të këtij ligji parashikohet ngritja e Regjistrit Pronarëve Përfitues, i cili është ngritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe AKSHI, dhe administrohet nga QKB.

Ndërkohë, në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor për identifikimin, raportimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues, janë parashikuar masat ndëshkuese në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi ligjor, brenda afatit të parashikuar në ligj.

ANGAZHIMET	
ANGAZHIMI SPECIFIK	
Planet e Integritetit	
Pronarët Përfitues	
KOMPONENTI 1:	
Qeveria e Hapur me qëllim luftën kundër korrupsionit	
PERIUDHA E IMPLEMENTIMIT: Viti 2020; 6M1 (janar-qershor) 2021	
Institucioni udhëheqës	Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
PERSHKRIMI I ANGAZHIMIT	
Cila është problematika dhe çfarë do të adresojë angazhimi respektiv?	<p><i>Planet e Integritetit:</i></p> <p>Abuzimet e mundshme në organet e administratës publike, shkelja dhe mosrespektimi i procedurave krijojnë gjasa për ekspozim të institucioneve publike ndaj rreziqeve të korrupsionit në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre.</p> <p>Adresimi i korrupsionit paraqet një sfidë të rëndësishme që kërkon masa në të gjitha nivelet e administratës publike. Që nga viti 2017, Ministria e Drejtësisë në rolin e saj si Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit ka udhëhequr përpjekjet e politikës anti-korrupsion të qeverisë dhe përgatitjen e ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse. Si institucioni kryesor përgjegjës publik për antikorrupsionin, MD/Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit udhëheq angazhimin ndërinstytucional për të siguruar një performancë dhe kulturë më të lartë në luftën kundër korrupsionit. Ky angazhim ndërinstytucional përqendrohet në sektorët më të prekshëm dhe të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe përpiqet të promovojë dhe sigurojë një administratë publike të paanshme, të ndershme dhe efikase me nëpunës civilë dhe zyrtarë të tjerë publik me vlera, parime dhe integritet të lartë.</p> <p>Plani i Integritetit është një instrument i aplikueshëm që forcon dhe përmirëson performancën e institucioneve publike, llogaridhënien dhe transparencën e tyre. Ministria e Drejtësisë është institucioni i parë në nivel qendror që ka kryer një vlerësim risku të integritetit dhe ka hartuar një Plan Integriteti. Ky është një dokument model për institucionet e varësisë së saj dhe të ministrive të linjës, një dokument që përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Ministrisë së Drejtësisë dhe janë identifikuar dhe planifikuar aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit i MD-së do të ndikojë pozitivisht ministrinë e linjës, si edhe institucionet e varësisë, në axhendat e tyre institucionale kundër korrupsionit. Metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit për qeverisjen qendrore, e aplikuar për së pari në Ministrinë e Drejtësisë në vitin 2020, do të jetë një model dhe udhëzues vlerësimi edhe në institucionet e</p>

	<p>tjera të administratës qendrore.</p> <p><i>Pronarët Përfitues:</i></p> <p>Republika e Shqipërisë, deri në vitin 2021 nuk kishte një mekanizëm e cili mund të identifikonte se cilët janë pronarët e vërtetë përfitues të subjekteve të rregjistruara në Shqipëri.</p> <p>Për këtë arsye, Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) rekomandoi ngritjen e një regjistri i cili do të bëjë të mundur rregjistrimin e pronarëve real përfitues.</p>
<p>Cili është angazhimi?</p>	<p><i>Planet e Integritetit:</i></p> <p>Komponenti 1/ Planet e Integritetit:krijon një kornizë për zhvillimin dhe zbatimin e planeve të integritetit në të gjithë administratën publike.</p> <p>Qëllimi politik i tij është të krjojë një metodologji, të vlerësojë dhe të zhvillojë jo vetëm rritjen e integritetit brenda Ministrisë së Drejtësisë, por gjithashtu për të udhëhequr këtë shembull në ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë. Angazhimi i jep përparësi kornizave të strukturuar të raportimit dhe mekanizmave konsultativë dhe monitorues që promovojnë përfshirjen e qytetarëve dhe llogaridhënien e tyre</p> <p>Objektivi politik i këtij angazhimi është të garantojë një sistem të funksionimit të administratës publike që promovon transparencën, llogaridhënien, rregullin dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për të përmirësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik.Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të integritetit që përcaktojnë qartë detyrimet etike në vendin e punës në të gjithë administratën publike synon të ndërtojë dhe mirëmbajë një kulturë pune të praktikave etike të punës.</p> <p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimi i planit të integritetit dhe metodologjia e vlerësimit të rrezikut të integritetit për qeverinë qendrore janë miratuar; - Vlerësimi i rrezikut të integritetit i kryer në institucionet e varësisë të Ministrisë së Drejtësisë dhe janë miratuar planet e integritetit; - Forcimi i kapaciteteve të stafit teknik të MD për identifikimin e rreziqeve të integritetit - Mekanizmat e informimit dhe prezantimit tek MD dhe institucionet vartëse të ML, për procesin e vlerësimit të rrezikut dhe prezantimin e udhëzuesit të integritetit - Rritja e transparencës nga institucionet e administratës publike (e-buletini)

	<p><i>Pronarët Përfitues:</i></p> <p>Me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës dhe angazhimeve të ndërmarra në Planin Kombëtar OGP 2020-2022, Kryeministri ngriti grupin ndërinstytucional të punës për zbatimin e rekomandimeve të MONEYVAL. Në vijim të këtij procesi, ministri i Financave dhe Ekonomisë ngriti ngrupim ndërinstytucional të punës, me pjesëmarrjen e përfaqësueve të insitucioneve përgjegjëse në varësi të kësaj ministrie dhe pjesë e të cilit ishte edhe Qendra Kombëtare e Biznesit, për ndjekjen, koordinimin dhe raportimin e progresit të masave të përcaktuara në planin e veprimit, për përmbushjen e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës. Ky grup pune kishte për detyrë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shqyrtimin e legjislacionit shqiptar; – vlerësimin e praktikave më të mira; – hartimin e rekomandimeve për krijimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues. <p>Për sa më sipër, në kuadër të detyrave të ngarkuara nga grupi i punës për zbatimin e rekomandimeve të MONEYVAL për krijimin në vendin tonë të një regjistri për pronarin përfitues, Ministria e Financave dhe QKB me asistencën e GIZ, bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në praktikën e vendeve të huaja, hartuan Ligjin Nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”.</p>
<p>Si do të kontribuojë angazhimi për të zgjidhur problematikën përkatëse?</p>	<p><i>Planet e Integritetit:</i></p> <p><i>Cilat kanë qenë hapat paraprake:</i></p> <p>Angazhimi “Planet e integritetit” përfshin vlerësimin e riskut të integritetit në institucionet e administratës qendrore.</p> <p>Për këtë u krijua një model bashkëpunimi midis MD dhe me OSHC, për të hartuar një metodologji të vlerësimit të riskut të integritetit, që do të aplikohet në vijim në institucionet e tjera të administratës qendrore.</p> <p>Vlerësimi i riskut u mbështet në fushat funksionale të Ministrisë së Drejtësisë; janë zhvilluar workshopet me qëllim forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë me praktikën dhe procedurat më të mira, duke i trajnuar mbi zbatimin e kornizave dhe mjeteve të vlerësimit në mënyrë që të forcojnë teknikat metodologjike në identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve të integritetit; përmes të njëjtit bashkëpunim është hartuar "Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë; si dhe ka filluar procesi në varësitë e MD-së; si dhe për të siguruar zbatimin e duhur të planeve të integritetit, ato do të shoqërohen nga një proces gjithëpërfshirës monitorimi që ndjek një kornizë të strukturuar monitorimi dhe vlerësimi (instrumenti metodologji</p>

monitorim).

Informacion lidhur me masat prioritare:

Ky angazhim për periudhën vitin 2020 dhe 6M1 (janar-qershor) 2021 ka kontribuar me 2 masa prioritare si vijon:

Masa prioritare 1 - Planet e Integritetit të hartuara dhe miratuara nga institucionet qendrore

Viti 2020:

Ministria e Drejtësisë/KKKK ka hartuar dhe miratuarnë vitin 2020, dokumentin “Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”. Ky dokument është kryer në bashkëpunim (vlerësimi dhe konsolidimi, publikimi) me organizatën ‘Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)’. Metodologjia është miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2020 “Për miratimin e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore”.

Metodologjia është shpallur publikisht në faqen zyrtare të MD (versioni shqip dhe anglisht) në tetor 2020, link i publikimit:

<https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/3.->

[Metodologjia-e-Vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-Riskut-t%C3%AB-Integritetit-p%C3%ABr-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore_AL.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/3.-Metodologjia-e-Vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-Riskut-t%C3%AB-Integritetit-p%C3%ABr-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore_AL.pdf)

<https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/4.->

[Metodologjia-e-Vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-Riskut-t%C3%AB-Integritetit-p%C3%ABr-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore_EN.pdf](https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/4.-Metodologjia-e-Vler%C3%ABsimit-t%C3%AB-Riskut-t%C3%AB-Integritetit-p%C3%ABr-Institucionet-e-Qeverisjes-Qendrore_EN.pdf)

(pika e referimit 1; pika e referimit 3).

Në MD gjatë vitit 2020, janë zhvilluar disa workshope që kanë njohur dhe forcuar kapacitetet e Ministrisë së Drejtësisë me praktikantët dhe procedurat më të mira, duke i trajnuar mbi zbatimin e kornizave dhe mjeteve të vlerësimit duke forcuar teknikat metodologjike në identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e rreziqeve të integritetit. Në periudhën janar 2020 janë zhvilluar 13 takime e seminare (Datat 15 -23 janar 2020, takime (fokus-grupe), me qëllim identifikimin e të gjitha proceseve të punës që ndjek MD dhe që mund të jenë të ekspozuara përballë korrupsionit, shkeljeve të integritetit, sjelljet joetike dhe joprofesionale dhe të tjera parregullësi, si dhe së dyti identifikimi dhe analiza e riskut të integritetit. Takimet evidentuan risqet e integritetit sipas fushave dhe ndikimin e tyre në fushën e përgjegjësisë së MD.

Në muajin shkurt u krye analizimi dhe vlerësimi i intensitetit të risqeve të identifikuar në MD; në muajin mars u vijua me trajtimin e risqeve prioritare dhe atyre të moderuara si edhe hartimin e planit të integritetit të MD.

Në periudhën prill-maj-qershor u krye finalizimi i draft-dokumentit: Metodologji për monitorimin e PI për institucionet e qeverisjes qendrore dhe Plani i Integritetit të MD.

Grupi i punës së bashku me ekipin e ekspertëve të OSHC (IDM Albania) kanë qënë të fokusuar në trajnimin e stafit mbi forcimin e kapaciteteve të stafit teknik të MD për identifikimin e risqeve të integritetit (sipas proceseve të punës; Analiza dhe vlerësimi i intensitetit të risqeve të identifikuar). *(pika e referimit 2).*

Në vitin 2020, MD/KKK përmes të njëjtit bashkëpunim me OSHC (IDM Albania) ka hartuar dhe finalizuar dokumentin "Plani i Integritetit i Ministrisë së Drejtësisë 2020-2023", përmes një procesi të hapur dhe konsultativ. Ky dokument është miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.333, datë 07.10.2020. Plani i Integritetit është shpallur për publikim në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë në tetor 2020 (versioni shqip dhe anglisht), link i publikimit:

https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1.-Plani-i-Integritetit-p%C3%ABr-Ministrin%C3%AB-e-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-2020-2023_AL.pdf

https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/2.-Plani-i-Integritetit-p%C3%ABr-Ministrin%C3%AB-e-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-2020-2023_EN.pdf. *(pika e referimit 4).*

Në muajin nëntor 2020, është bërë dërgimi zyrtar i MVRI pranë varësive të MD (shkresa nr. 6158/5 datë 9.11.2020) për njohje dhe zbatim dhe është zhvilluar tryeza e promovimit dhe njoftimit të dokumentit Metodologji e vlerësimit të riskut të integritetit dhe Plani i Integritetit të MD, në prezencë të anëtarëve të Komitetit Koordinator Kundër Korrupsionit, ministrive të linjës, varësive të MD-së, OSHC dhe partnerëve të huaj, tryezë në formatin fizikisht dhe online. <https://www.drejtesia.gov.al/newsroom/fjalime/fjalime-zevendesministres-pirdeni-metodologjia-e-vleresimit-te-riskut-te-integritetit-ne-institucionet-e-qeverisjes-qendrore/> *(pika e referimit 5).*

Gjithashtu, pika e referimit 5 referohet në raportin vjetor të monitorimit të PV SNKK, 2020, link: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/1.-Raporti-i-monitorimit-SNKK-Janar-Dhjetor-2020_AL.pdf; (alb)

https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/2.-Raporti-i-monitorimit-SNKK-Janar-Dhjetor-2020_EN.pdf(eng)

Viti 2021:

Ministria e Drejtësisë/KKKK ka zhvilluar gjatë muajit janar, shkurt e prill 2021, 3 takime mbi vlerësimin e riskut të integritetit në varësitë e saj dhe

hartimin e PI, përkatësisht:

1. Takim lancimi i fillimit të vlerësimit të riskut të integritetit në institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë. Hartimi i Planit të Integritetit në këto institucione, datë 12.01.2021, *(via zoom)*

2. Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë. Hartimi i Planit të Integritetit, datë 11.02.2021 *(via zoom)*

3. Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë (Sh. Provës/SHKBB/ASHSGJ/DNJF/ AKF); Hartimi i Planit të Integritetit, datë 12.04.2021.

Duke ndjekur metodologjinë e zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë, institucionet e varësisë janë në proces vlerësimi të riskut të integritetit dhe në proces hartimi të planevetë integritetit në përputhje me fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë dhe faktorëve specifikë të rrezikut. Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë kanë ngritur grupet e punës për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe janë në proces hartimi të PI;

Procesi i vlerësimit të riskut të integritetit ka përfunduar në dy institucione varësie, përkatësisht në DNJF dhe SHKBB dhe vijon të jetë ende në proces në të gjitha institucionet e tjera të varësisë, përkatësisht në DPB, DPP, DPSHP, ATP, QBZ, IML, KSHB, ASHSGJ dhe AKF. Ky proces vijon dhe pritet të përfundojë me finalizimin dhe miratimi e PI të varësitë e MD brenda vitit 2021. *(pika e referimit 6).*

Në fund të muajit qershor 2021, MD/KKK shpërndau dhe publikoi e-buletini me aktivitete të muajit Qershor 2021, në kuadër të rritjes së transparencës nga institucionet e administratës publike, link i publikimit:

<https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/AK-Newsletter--Qershor-2021.pdf>

<https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/AC-Newsletter--June-2021.pdf>, *(pika e referimit 8).*

Masa prioritare 2- Analizë gjithëpërfshirëse mbi zbatueshmërinë e planeve të integritetit në MD dhe ML

Për të siguruar zbatimin e duhur të planeve të integritetit, MD është në proces hartimi të një draft/instrumenti: Metodologji për monitorimin e Planit të Integritetit të institucioneve të qeverisjes qendrore.

- Drafti është shpallur për konsultim publik në faqen web të MD <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/DRAFT-METODOLOGJI-MONITORIMI-PI.pdf>

Ky dokument është dërguar për konsultim pranë OSHC (partnere në proces)

	<p>nëpërmjet e-mail dhe po përgatitet zhvillimi i një tryeze konsultimi (online) në muajin korrik 2021. (pika e referimit 9).</p> <p><i>Pronarët Përfitues:</i></p> <p>Referuar dispozitave ligjore në fuqi deri në vitin 2020, subjektet e regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe të dhënat e tyre, ndër të tjera, lidhur me objektin e aktivitetin dhe gjendjen e ortakërisë, regjistrohen dhe administrohen në Regjistrin Tregtar (QKB) dhe në Regjistrin e Organizatave jofitimprurëse (aktualisht Gjykatë-DPT).</p> <p>Ndërkohë, në rekomandimet e MONEYVAL, u kërkua ndërtimi i një regjistri, në bazë të të cilit të identifikohet dhe të regjistrohet pronari përfitues i subjekteve tregtare dhe organizatave jofitimprurëse, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Për sa më sipër, ky ligj përmbush një nga detyrat e caktuara nga grupi ndërinstucional i punës për zbatimin e rekomandimeve të MONEYVAL, të ngritur nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës.</p> <p>Me anë të këtij ligji, nëpërmjet përkufizimit të pronarit përfitues, caktimit të subjekteve që kanë detyrimin e regjistrimit të tyre pranë regjistrit të krijuar për këtë qëllim, duke përcaktuar njëkohësisht dhe të drejtat e detyrimit e tyre, të institucionit të ngarkuar me regjistrimin e të dhënave dhe administrimin e tyre dhe të institucioneve të tjera që me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore duhet të aksesojnë në të dhënat e regjistruara, synohet të identifikohet pronari përfitues, i cili ka i fundit në pronësi ose ushtron kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik (subjekt tregtar dhe OJF), të regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe identifikuar me NUIS/NIPT.</p> <p>Gjithashtu, me anë të këtij ligji parashikohet ngritja e Regjistrit Pronarëve Përfitues, i cili është ngritur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe AKSHI, dhe administrohet nga QJB</p> <p>Ndërkohë, në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor për identifikimin, raportimin dhe regjistrimin e pronarit përfitues, janë parashikuar masat ndëshkuese në rast të mospërmbushjes së këtij detyrimi ligjor, brenda afatit të parashikuar në ligj.</p>
<p>Përse është ky angazhim relevant me vlerat e Qeverisjes së Hapur/OGP?</p>	<p><i>Planet e Integritetit:</i></p> <p>Ky objektivi është relevant me vlerat e Qeverisjes së Hapur/OGP pasi vjen konform katër parimeve të OGP që janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Transparenca dhe Qasja në Informacion;</i>

Të gjitha takimet konsultative, tryezat e punës, konsultimi i draft dokumenteve si metodologji e vlerësimit të riskut të integritetit në institucionet e qeverisjes qendrore; plani i integritetit të MD; e-buletini janë publikuar dhe janë të disponueshme publikisht. **(Pika e referimit 3,4,5, 8, 9)**

2. Përgjegjësia publike;

Hartimi dhe finalizimi i akteve/instrumenteve të luftës kundër korrupsionit ndjekin progresin e nismës dhe angazhimit tëbashkëbërjes me qytetarë dhe grupe interesi jashtë administratës. Proceset janë plotësuar përmes konsultimeve publike dhe janë publikuar dhe/apo janë në process bashkëpunimi me OSHC-të. **(Pikat e referimit 1,2,3,4,5,6,9)**

3. Pjesëmarrja Publike dhe Qytetare;

Angazhimet e paracaktuara në këtë komponent janë mundësuar me bashkëpunime grupe të caktuara interesi si OSHC, duke ndihmuar në promovimin e angazhimit publik dhe civil në disa nivele.

Iniciativat e planifikuara në këtë plan veprimi synojnë të inkurajojnë qytetarët të përdorin mekanizmat për të kontrolluar funksionimin e administratës publike drejt llogaridhënies dhe transparencës dhe të afrojnë më shumë qytetarët ndaj përdorimit të këtyre strukturave dhe mjeteve të kontrollit të tyre. **(Pikat e referimit 1,4,9)**

4. Teknologji dhe Inovacion.

Publikimi në internet/ dhe në Web të MD i dokumenteve të hartuara mundëson transparencën në kohë reale së bashku me mundësitë në internet për konsultime me palët e interesuara dhe reagimet e tyre u mundësojnë që një numër më i madh i qytetarëve të marrin pjesë dhe të japin reagime. Për më tepër, përdorimi i një buletini elektronik do të mbështesë transparencën dhe llogaridhënien mbi zbatimin e implementimit të integritetit. **(Pika e referimit 3,4,8,9)**

Pronarët Përfitues:

Ky objektivi është relevant me vlerat e Qeverisjes së Hapur/OGP pasi vjen konform katër parimeve të OGP që janë:

1. Transparenca dhe Qasja në Informacion;

Të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, të cilat do të jenë lirisht të aksesueshme dhe publike janë:

- a) emri dhe mbiemri i pronarit përfitues;
- b) shtetësia;
- c) viti dhe muaji i lindjes;

- d) ç) data e përcaktimit të individit si pronar përfitues;
- e) lloji dhe përqindja e pronësisë:

- direkte
- indirekte

Të dhënat e tjera të pronarëve përfitues, të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues dhe të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme, do të mund të aksesohen nga:

- a) personat e autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues vetëm në të dhënat e regjistruara në regjistër për subjektin që ato përfaqësojnë;
- b) autoritetet kompetente shtetërore:
 - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
 - Banka e Shqipërisë;
 - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
 - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
 - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
 - Prokuroria;

2. Përgjegjësia publike;

Autoritetet kompetente shtetërore do të kenë akses elektronik të lirë, direkt dhe të pakufizuar në të dhënat e regjistruara në regjistër, në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre ligjore që lidhen me inspektimin e Regjistrit të Pronarëve Përfitues dhe mbledhjen e të dhënave mbi pronarët përfitues.

Subjektet e detyruara mund të marrin informacion për të dhënat e regjistruara në regjistër, të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme dhe publike, kur këto të dhëna nevojiten për përmbushjen e detyrave të tyre ligjore.

Çdo person mund të marrë informacion për të dhënat e regjistruara në regjistër, të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme dhe publike, vetëm nëse provon se ka një interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacion.

3. Pjesëmarrja Publike dhe Qytetare;

Autoritetet shtetërore kompetente, në rastet kur të dhënat e regjistruara në regjistër nuk përputhen me të dhënat në posedim të tyre, njoftojnë QKB.

Gjithashtu, nëse një subjekt i detyruar konstaton se të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues nuk përputhen me të dhënat e zotëruara nga ky subjekt i detyruar për pronarët përfitues, atëherë subjekti i detyruar njofton subjektin raportues dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Teknologji dhe Inovacion.

Të gjitha të dhënat për pronarët përfitues regjistrohen në Regjistrin e

	<p>Pronarëve Përfitues.</p> <p>Regjistri i Pronarëve Përfitues është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilin regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin e raportimit të tyre, që në kohë reale të dhënat të regjistruara në regjistrat respektivë shtetërorë, të administruara nga institucionet shtetërore përkatëse.</p> <p>Regjistri i Pronarëve Përfitues shërben si arkiv elektronik zyrtar dhe siguron transparencën në fushën e pronarëve përfitues.</p> <p>Regjistri i Pronarëve Përfitues administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit.</p>			
<p>Informacion shtesë</p>	<p><i>Planet e Integritetit:</i></p> <p>Ky angazhim është në relevancë me Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe planin e veprimit 2020-2023. Strategjia dhe plani i veprimit veprojnë si udhërrëfyes për fusha specifike të luftës kundër korrupsionit në vend, përkatësisht Qasja A: Parandaluese/ objektivi specifik A8 dhe A9:</p> <p>-A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion</p> <p>-A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë</p> <p><i>Pronarët Përfitues:</i></p> <p>Procesi i regjistrimit i pronarëve përfitues të subjekteve raportuese ekzistuese filloi më 01 shkurt 2021 dhe përfundoi më 30 qershor 2021.</p> <p>Deri më 30 Qershor 2021, nga 52 263 persona juridikë të regjistruar dhe OJF të regjistruara në regjistrat përkatës, 23 307 subjekte raportuese kane regjistruar pronarët e tyre përfitues në regjister, nga të cilët 1 894 janë OJF dhe 21 413 janë subjekte tregtare.</p> <p>Ndërkohë, subjektet raportuese kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë çdo ndryshim të të dhënave tashmë të regjistruara të pronarëve të tyre përfitues, brenda 30 ditëve kalendarike nga të data e ndryshimit faktik të të dhënave.</p>			
<p>Niveli i realizimit</p>	<p>Nuk ka filluar</p>	<p>Limituar</p>	<p>Konsiderueshëm</p>	<p>Përfunduar</p>
<p>Përshkrimi i rezultateve</p>	<p><i>Planet e Integritetit:</i></p>			
				<p>X</p>

	<p>Referojuni ‘Aktiviteve/Milestone’</p> <p>Referojuni ‘Si do të kontribojë angazhimi për të zgjidhur problematikën përkatëse?’</p> <p>Pikat e referimit 1,2,3,4,5 dhe 8 janë përfunduar.</p> <p>Pikat e referimit 6 dhe 9 janë në vijueshmëri sipas planifikimit të bërë në PV.</p> <p><i>Pronarët Përfitues:</i></p> <p>Hartimi dhe miratimi i Ligjit Nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues” dhe aktet nënligjore përkatëse</p> <p>Ngritja e Regjistrit të Pronarëve Përfitues</p>		
Hapat e tjere	<p><i>Planet e Integritetit:</i></p> <p>Pika e referimit 6 “<i>Vlerësimi i rrezikut të integritetit në institucionet vartëse të MD sipas modelit të zhvilluar në MD dhe Plani i Integritetit i hartuar</i>” është ende në proces pasi disa institucione varësie janë duke përfunduar proceset e vlerësimit të riskut dhe PI.</p> <p>Pika e referimit 9 “<i>Dokumenti i metodologjisë: instrumenti për monitorimin e Planeve të Integritetit në institucionet e qeverisjes qendrore</i>” është gjithashtu në proces. Hartimi i draft/instrument: Metodologji për monitorimin e PI të institucioneve qendrore është në proces konsultimi publik në faqen zyrtare të MD-së dhe OSHC-të.</p> <p>Do të organizohet një tryezë konsultimi me OSHC-të dhe më pas pritet të finalizohet me miratimin e Ministrisë së Drejtësisë.</p>		
<p>Aktivitetet/milestone në raport me produktet e verifikueshme</p> <p>Objektivi specifik: planet e integritetit</p>	Fillimi	Përfundimi	Niveli i realizimit
Pika referimit 1: Dokumenti i metodologjisë: Hartuar metodologjia e vlerësimit të rrezikut udhëzues / integritet për qeverinë qendrore	6M1 2020	6M2 2020	Përfunduar
Pika referimit 2: Forcimi i kapaciteteve të stafit teknik të MD për identifikimin e rreziqeve të integritetit	6M1 2020	6M2 2020	Përfunduar

Pika e referimit 3: Miratimi dhe Publikimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit për qeverinë qendrore	6M2 2020	6M2 2020	Përfunduar
Pika referimit 4: Hartimi, konsultimi, miratimi dhe publikimi I dokumentit PI të MD	6M2 2020	6M2 2020	Përfunduar
Pika referimit 5: Mekanizmat e informimit dhe prezantimit tek MD dhe institucionet vartëse të ML, për procesin e vlerësimit të rrezikut dhe prezantimin e udhëzuesit të integritetit	6M2 2020	6M2 2020	Përfunduar
Pika e referimit 6: Vlerësimi i rrezikut të integritetit në institucionet vartëse të MD sipas modelit të zhvilluar në MD dhe Plani i Integritetit i hartuar	6M1 2021	6M2 2021	Në proces
Pika e referimit 8: Rritja e transparencës nga institucionet e administratës publike në IP-në (e-buletini)	6M1 2021	6M2 2022	Përfunduar
Pika referimit 9: Dokumenti i metodologjisë: instrumenti për monitorimin e Planeve të Integritetit në institucionet e qeverisjes qendrore	6M1 2021	6M1 2021	Në proces
Aktivitetet/milestone në raport me produktet e verifikueshme	Fillimi	Përfundimi	Niveli i realizimit
Objektivi specifik: pronarët përfitues			
Pika referimit 1: Hartimi dhe miratimi i Ligjit Nr. 112/2020 “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues” dhe aktet nënligjore përkatëse	6M1 2020	6M2 2020	Përfunduar
Pika referimit 2: Ngritja e Regjistrit të Pronarëve Përfitues	6M2 2020	6M1 2021	Përfunduar
Informacion kontakti			
Emri i personit përgjegjës nga institucioni drejtues	Rovena Pregja Flogers Broqi		
Titulli, Departamenti	Ministria e Drejtësisë- Drejtoria e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion MFE/QKB		

E-mail dhe telefon	Rovena.Pregja@drejtesia.gov.al Hener.Shanaj@drejtesia.gov.al Romena.Qamo@qkb.gov.al Flogers.Broqi@qkb.gov.al	
Aktorë të tjerë të përfshirë	Aktorë të tjerë të përfshirë	OSHC:IDM, ICC Albania, CRCA, EM-AL, CD-institute, Partners Albania, Qendra Altri, NDI, AHC.
	Grupe pune, CSO, sektori privat, etj	Grupi i Punës për hartimin e PI dhe MVRI. Struktura teknike që hartoi metodologjinë e monitorimit të PI për institucionet e qeverisjes qendrore (Drejtoria e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion).

ANGAZHIMI 3: Qeverisja elektronike përmes ofrimit të shërbimeve publike në portalin e-Albania

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Angazhimi është në harmonizim me strategjinë e gjerë qeveritare të përmirësimit të shërbimeve publike, përkatësisht Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike 2015-2020. Duke ndjekur Strategjinë Ndërsektoriale 2015-2020, qeveria shqiptare ka filluar një rrugë pa kthim drejt sigurimit të shërbimeve publike online dhe dixhitalizimit të plotë të proceseve të punës së administratës. Reduktimi i numrit të dokumenteve shoqëruese të kërkuara për qytetarët / bizneset dhe gjithashtu ri-inxhinierimin e të gjithë procesit të sigurimit të tyre, në mënyrë që të zvogëlohen hapat e përpunimit, të dixhitalizohen proceset e brendshme duke ulur kështu burokracitë, kostot dhe kohën për qytetarët.

Kjo qasje e centralizuar e shërbimeve të e-Qeverisjes ka mundësuar që të ketë standardizim të shërbimeve dhe madje zhvillim midis infrastrukturës së TIK-ut të institucioneve publike në të gjithë vendin, të rrisë cilësinë e shërbimeve tona pasi proceset e sigurimit të cilësisë kryhen në mënyrë më rigoroze, njohuri më të shpejtë dhe ndarje të problemeve midis specialistëve tanë që rezultojnë në përdorimin më të mirë të burimeve njerëzore. Mundësimi i shërbimeve online nënkupton ofrimin e tyre pa ndonjë kosto shtesë për qytetarët / bizneset, pa pritur në radhë në sportelet e shtetit duke mos humbur kështu kohë dhe pa patur ndonjë kontakt fizik me punonjësit e administratës duke eliminuar kështu korrupsionin.

Centralizimi i shërbimeve publike në platformën e-Albania mundëson rritjen e llogaridhënies publike në tre nivele:

- Së pari, një platformë elektronike krijon gjurmueshmëri për veprimet e ofrimit të shërbimeve dhe zvogëlon nevojën për kontakte ballë për ballë midis qytetarëve dhe punonjësve të administratës publike duke zvogëluar mundësitë që korrupsioni të ndodhë ose të mbetet pa u vërejtur.
- Së dyti, shërbimet publike në platformë duhet të plotësojnë kritere të mirëpërcaktuara dhe pajtueshmëria me këto kritere monitorohet gjithmonë. Vendosja dhe zbatimi i një kriteri të unifikuar ndërmjet institucioneve publike eliminon ndryshimet në praktikat administrative nëpër institucione dhe heq paqartësinë dhe për pasojë, jo vetëm që promovon rritjen e efikasitetit në të gjithë administratën publike, por gjithashtu zvogëlon mundësitë për korrupsion dhe keqmenaxhim.
- Së treti, platforma e-Albania nuk është një mekanizëm përgjegjshmërie vetëm ndaj institucioneve të brendshme, por edhe përmes mekanizmave të jashtëm që mundësojnë pjesëmarrjen qytetare drejt përmirësimit të saj të vazhdueshëm. Përmes fushatës së ndërgjegjësimit për të aftësuar qytetarët dhe bizneset dhe mekanizmin e saj të feedback (aktiviteti 2), platforma e-Albania promovon një kulturë dhe përjasje me në qendër qytetarin për transformimin e shërbimeve publike. Një platformë elektronike që eliminon reagimet personale ose fizike dhe mbrojtjen e garantuar të privatësisë për qytetarët synon të stimulojë qytetarët që jo vetëm të përdorin platformën, por të sigurojë reagime dhe rekomandime, të sigurta që identiteti i tyre do të mbrohet.

ANGAZHIMI3

Qeverisja elektronike përmes ofrimit të shërbimeve publike në portalin e-Albania

2020-2022

Institucioni udhëheqës

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Përshkrimi i angazhimit

**Cila është
problematika dhe çfarë
do të adresojë
angazhimi respektiv?**

Modelet efikase dhe efektive të ofrimit të shërbimeve publike janë thelbësore jo vetëm për të përmbushur nevojat e qytetarëve, por edhe për të zvogëluar tërheqjen dhe mundësitë për korrupsion. Përdorimi i shërbimeve publike mund të imponojë barra të konsiderueshme administrative mbi qytetarët dhe bizneset nëse u kërkon atyre të aksesojnë sisteme burokratike të ndryshme, që marrin shumë kohë dhe komplekse me kërkesa dhe procese të paqarta, jo të standardizuara të aplikimit.

Kur qytetarët dhe bizneset kanë kontakt të drejtpërdrejtë me zyrtarë të administratës krijohen stimuj dhe mundësi për të rritur rrezikun e korrupsionit në ofrimin e shërbimeve publike. Për më tepër, joefikasiteti i këtyre modeleve të ofrimit të shërbimeve të ndërlikuara shpërdoron burimet qeveritare që përndryshe mund të kanalizohen në shërbimet publike.

Që nga viti 2014, Shqipëria ka punuar drejt transformimit të ofrimit të shërbimit publik drejt një modeli të ofrimit të shërbimit efikas dhe në qendër të qytetarëve. Promovimi i llogaridhënies publike dhe angazhimit dhe pjesëmarrjes qytetare kërkon jo vetëm rritjen e aksesit në informacion dhe burime, por edhe ndryshim të mentalitetit për ofrimin e shërbimeve publike dhe ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre si përfitues të shërbimeve publike.

Me qëllim zhvillimin e një modeli të ofrimit të shërbimeve që përdor teknologjinë dhe platformat online për të drejtuar burokracinë në një mënyrë transparente dhe të standardizuar, qeveria e Shqipërisë ka punuar për të rritur mundësinë e përdorimit dhe përgjegjshmërinë e ofrimit të shërbimeve publike dhe për të ndërtuar besimin e publikut në shërbimet qeveritare.

<p>Cili është angazhimi?</p>	<p>Digjitalizimi i shërbimeve publike, më shumë se 1200 shërbime publike ose 95% e të gjithë shërbimeve publike do të sigurohen në platformën e-Albania.</p> <p>Objektivi:</p> <p>Transformimi i shërbimeve publike në shërbime vetëm elektronike synon të vendosë kornizën dhe mekanizmat e nevojshëm jo vetëm për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, por edhe për ndryshimin e mendjes së qytetarëve drejt komunikimit elektronik me institucionet publike. Kalimi në aplikime vetëm online synon të zvogëlojë ndjeshëm burokracinë dhe kostot administrative për qytetarët dhe bizneset duke i lehtësuar ata nga barra e detyrimit për të mbledhur fizikisht kopje fizike të dokumenteve shtetërore si dhe për administratën publike përmes një sistemi më të efektshëm.</p> <p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i 95% të të gjitha shërbimeve publike në mënyrë elektronike; • Rritja e aftësive të qytetarëve në lidhje me mjetet e qeverisjes elektronike; • Rritja e angazhimit të qytetarëve dhe rritja e llogaridhënies publike nga qytetarët; • Rritja e transparencës dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve; • Ulja e kostove të ofrimit të shërbimeve; • Procedurat e efektshme burokratike; • Parandalimi i mundësive për korrupsion.
<p>Si do të kontribuojë angazhimi për të zgjidhur problematikën përkatëse?</p>	<p>Platforma e-Albania u mundëson qytetarëve të kenë akses online për shërbimet publikeduke vepruar si portë digjitale për të lehtësuar aksesin e ofruesve të shërbimeve dhe përfituesve në informacion, procedurat elektronike dhe ndihmën për marrjen e shërbimeve. Platforma e-Albania është dizenuar duke pasur parasysh qasjen e përdoruesit, duke lejuar këdo, pavarësisht nga niveli i tij i aftësive digjitale, të ketë qasje në shërbimet online përmes një ndërfaqe të adaptueshme dhe intuitive. Si një sistem i përputhshëm me standardet e bazuara në internet, platforma e-Albania është e arritshme nga çdo pajisje, përfshirë telefonat inteligjentë, televizionet dhe kioskat digjitale në vendet publike.</p> <p>Pasi të centralizohen dhe standardizohen në mënyrë efektive të gjitha shërbimet publike, ky angazhim do ta vendosë platformën</p>

	<p>si qendër të shërbimit publik, duke ulur në mënyrë drastike kohën që qytetarët dhe bizneset duhet të kalojnë duke kërkuar dhe hyrë në shërbimet publike dhe për këtë arsye, duke rritur aksesin e qytetarëve e bizneseve për të marrë shërbime publike.</p> <p>Aktiviteti i dytë i angazhimit do të përqendrohet në lehtësimin e marrjes së shërbimeve të reja elektronike dhe krijimin e një mekanizmi përmirësimi të përqendruar te qytetarët. Një fushatë sensibilizuese, me materiale shoqëruese shpjeguese, do të synojë jo vetëm të edukojë qytetarët mbi aplikimet dhe përdorimin e platformës në mënyrë që ata të mund të përdorin plotësisht gamën e plotë të shërbimeve në dispozicion, por gjithashtu që ata të kenë informacionin dhe materialin e nevojshëm për të siguruar reagime të informuara. Si e tillë, kjo fushatë do të shoqërohet me një mekanizëm reagimi në mënyrë që qytetarët të jenë në gjendje të feedback mbi platformën dhe të kontribuojnë drejt një përmirësimi të vazhdueshëm të përqendruar te qytetarët dhe qasjes së platformës.</p>	
<p>Përse është ky angazhim relevant me vlerat e Qeverisjes së Hapur/OGP?</p>	<p>Transparenca dhe Aksesin në Informacion</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimet elektronike përmirësojnë aksesin për shërbimet publike nga qytetarët & bizneset; • Sigurojnë qasje të njëjtë në shërbimet publike në të gjithë sektorët e komunitetit; • Sigurojnë transparencë të institucioneve ofruese të shërbimeve dhe mbrojtje të privatësisë së përfituesve të shërbimeve.
	<p>Pjesëmarrja publike dhe civile</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimet elektronike zvogëlojnë barrën administrative për qytetarët & bizneset në marrjen e shërbimeve; • Rrisin mundësitë e qytetarëve për të bashkëvepruar me institucionet publike dhe për të ndikuar në politikat e vendimmarrjes së tyre; • Incentivojnë dhënien e feedback-ut nga qytetarët duke garantuar mbrojtjen e privatësisë së tyre.
¹Kavajë, Krujë, Shkodër, Gjirokastrë, Fier, Lushnjë, Tirana 2, Kukës, Elbasan, si dhe në Zyrat ADISA në Maliq, Belsh, Librazhd, Divjakë, Patos, Malësi e Madhe, Pogradec, Mat, Roskovec, Kolonjë dhe Tepelenë.

Informacion kontakti	
Institucioni përgjegjës	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)
Emri i personit përgjegjës nga institucioni drejtues	
Titulli, Departamenti	
E-mail dhe telefon	
Aktorë të tjerë të përfshirë	Aktorë të tjerë të përfshirë
	Grupe pune, CSO, sektori privat, etj

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Transparenca, llogaridhënia dhe aksesin në drejtësi janë parimet kyçe operacionale të njohura për qeverisje të mirë duke përbërë kështu shtyllën kryesore të demokracisë. E drejta e aksesit në drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe mirëfunksionimin e drejtësisë në vend.

Qeveria Shqiptare ka mbështetur iniciativën shumëpalëshe të ndërrmarë, siç është Partneriteti i Qeverisë së Hapur si një nga mjetet e rëndësishme që bashkon reformatoret e qeverisë dhe drejtuesit e shoqërisë civile për të promovuar rritjen e aksesit në drejtësi në shërbimet publike dhe rritjen e përgjegjësisë përmes qasjeve të koordinuara, me qëllim përmirësimin cilësisë së informacionit për publikun.

Ky komponent ka gjetur shtrirje të gjërë duke u materializuar dhe ndërlidhur fort me zbatimin e reformës në drejtësi, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND), Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion (SNKK), Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur (SDM), Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), si dhe masat e tjera të ndërrmara nga Qeveria në përmbushje të misionit të saj për një qeverisje/politikë të hapur, transparente dhe llogaridhënese.

Me iniciimin e Reformës në Drejtësi, një reformë e thellë që po prek në tërësi çdo element të sistemit aktual të drejtësisë, u iniciua edhe një reformim i sistemit të ndihmës juridike, duke ofruar një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe si njëmekanizëm lehtësues që përdoret për të rritur aksesin në drejtësi për grupet që nuk kanë mundësi financiare për të paguar tarifën ligjore pranë organeve/gjykatave dhe njëkohësisht për të mundësuar këshillim ose mbrojtje ligjore. Programet e ndihmës juridike falas synojnë të sjellin sistemin e drejtësisë më afër nevojës së qytetarëve. Për këtë arsye ky komponent është përqëndruar në sigurimin e mjeteve juridike efektive por edhe të arritshme dhe të përballueshme për zgjidhjen e problematikave.

Në këtë kuadër duhet theksuar se pavarësia e sistemit gjyqësor dhe integriteti i tij, janë një parakusht thelbësor për të siguruar që nuk ka diskriminim në administrimin e drejtësisë. Në përgjigje të nevojave dhe problematikave u synua ndërmarrja e angazhimeve duke përfshirë një qasje të trefishtëmbi aksesin, transparencën dhe llogaridhënien. Puna e realizuar në kuadër të këtij komponenti ka vijuar me prioritet me qëllim identifikimin e sfidave dhe përmirësimin e hapave të mëtejshëm për një proces zbatueshmërie efektive.

Prioriteti aktual mbi aksesin në drejtësi, do të vazhdojë me synimin për të përmirësuar këtë komponent dhe për të arritur një qeveri transparente në përputhje me praktikën më të mirë dhe standardet europiane.

ANGAZHIMET**ANGAZHIMI SPECIFIK****KOMPONENTI 3: ANGAZHIMI 6 dhe 7****Qeveri e Hapur me qëllim të Aksesit, Transparencës dhe Llogaridhënies****PERIUDHA E IMPLEMENTIMIT: 2020-2022****Institucioni udhëheqës****Ministria e Drejtësisë****PERSHKRIMI I ANGAZHIMIT****Cila është problematika dhe çfarë do të adresojë angazhimi respektiv?**

Komponenti 3 “Aksesi në drejtësi” synon adresimin e problematikave të faktorëve strukturorë dhe institucionalë, përfshirë këtu kompleksitetin dhe kostot e proceseve ligjore të cilët pengojnë qasjen në drejtësi veçanërisht për grupet vulnerabël dhe grupete marginalizuara. Një nga parimet dhe obligimet kryesore të udhëheqjes së mirëështë transparenca dhe llogaridhënia e cila ndikon drejtpërsëdrejti në besueshmërinë e qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë. Forcimi i efikasitetit, transparencës dhe paanësisë në gjykata është paraqitur si një sfidë e rëndësishme e cila kërkon krijimin e mekanizmave të thjeshtë dhe sa më pak burokratik për të siguruar shërbime të drejta, transparente, efektive, jodiskriminuese dhe të përgjegjshme që promovojnë aksesin në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Cili është angazhimi?

Qëllimi i politikës së komponentit III është ndërtimi dhe zhvillimi i një politike të hapur që i siguron qytetarëve të saj akses në drejtësi, transparencë dhe llogaridhënie. Angazhimi synohet të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit ndërinsitucional me institucionet publike/organizata kombëtare e ndërkombëtare si dhe aktorëve të shoqërisë civile në kuadër të forcimit të këtij komponenti gjithëpërfshirës duke u përputhur me kërkesat e integritit evropian. Ky angazhim përfshin një seri aktivitetsht të cilat synojnë implementimin e plotë të ofrimit dhe garantimit të ndihmës juridike efektive duke u siguruar qytetarëve akses të plotë. Gjithashtu, ky komponent adreson aktivitete/masa me synimin e zbatueshmërisë së tyre në kuadër të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe teknike me qëllim publikimin e informacionit të dobishëm për qytetarët, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e aksesit të informacionit.

Rezultatet e pritura:

- Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas plotësisht funksionale për të siguruar ndihmën ligjore dhe udhëzime të nevojshme për çdo qytetar në pamundësi për të për të paguar mbështetjen ligjore.
- Bashkëpunim i përmirësuar ndërmjet MD dhe klinikave ligjore, Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, Shoqatës së Avokatëve të Shqipërisë, OJF-

	<p>ve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqja e Ministrisë së Drejtësisë plotësisht funksionale me informacion të publikuar në kohë reale dhe të kuptueshëm. - Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe qasja në shërbime.
<p>Si do të kontribuojë angazhimi për të zgjidhur problematikën përkatëse?</p>	<p><i>Përmbledhje ekzekutive mbi rezultatet kryesore të cilat janë arritur në zgjidhjen e problemit të identifikuar.</i></p> <p>Në kuadër të përmirësimit të angazhimit, qeveria shqiptare ka qënë vazhdimisht në përmirësim të mekanizmave të duhur për të lehtësuar aksesin e qytetarëve në drejtësi dhe për të forcuar besimin e tyre tek sistemi i drejtësisë shqiptare. Si hap kryesor në fillimin e këtij procesi ishte evidentimi i masave prioritare që mund të promovojnë dhe rrisin aksesin, transparencën dhe llogaridhënien. Më tej u vijua me zbatimin dhe implementimin e aktiviteteve të propozuara dhe bashkëkrijuara nëpërmjet takimeve të koordinuara me aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit të cilët u inkurajuan të japin komente, ide dhe reagime të përgjithshme gjatë konsultimeve duke përbushur kështu kushtet dhe standardet e vendosura në kornizën e metodologjisë së OGP, si dhe hapi final vlerësimi i zbatueshmërisë së aktiviteteve të krijuara në kuadër të këtij komponenti. Angazhimet e sipërpërmendura në kuadër të procesit të zbatueshmërisë janë shoqëruar me rezultate ku evidentohen indikacionet pozitive dhe progres në kuadër të këtij komponenti.</p> <p><i>Angazhimi 6</i></p> <p><i><u>Masa prioritare 1: Ndhma Juridike ofrohet në formë efikase e cila u siguron qytetarëve në nevojë, qasje të plotë në një shërbim të tillë.</u></i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas <p>Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër nr. 59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndhmës Juridike Falas” me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në Shkurt të vitit 2021, është bërë i mundur rekrutimi i vendeve vakante të DNJF përfshirë këtu edhe stafin drejtues duke mundur kështu realizimin e këtij objekti në masën 100%.</p> <p>Sa i përket punonjësve me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, janë rekrutuar punonjësit pranë qendrave Lezhë, Vlorë, Fier dhe Dibër (5 punonjës).</p>

- **Trajnimi i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore**

Bashkëpunimi me Euralius

Datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”. Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Pjesë e trajnimit ishte stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë. U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (bashkëpunimi me ASPA, DHASH dhe UNDP)

Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore:

DNJF ka patur një komunikim të vazhdueshëm me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8, të ligjit nr.111/2017. Në kushtet kur buxheti i DNJF është i pamjaftueshëm për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF kërkoi nga ana e UNDP mbështetjen për zhvillimin e këtyre trajnimeve.

Përgjatë periudhës Maj-Qershor2021:

-U zhvillua kursi online “*Ndihma juridike parësore e garantuar nga shteti*” si pjesë e Projektit “Shtrirja e shërbimit të ndihmës juridike për gratë dhe burrat në Shqipëri” zbatuar nga PNUD në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC). Kursi online u zhvillua me një kohëzgjatje 18 orë në total ku çdo pjesëmarrës ka pasur mundësinë e coaching individual me trajneren Dr. Nadia Rusi dhe pjesëmarrjen e suksesshme të punonjësve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore. Me zhvillimin e këtij trajnimi u bë e mundur përmbushja e detyrimit ligjor të trajnimit të detyrueshëm të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Sa i përket trajnimit të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore :

Me qëllim asistimin e avokatëve në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore, raportimit për sa i përket ndjekjes së çështjeve, ndërveprimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Dhomat Vendore të Avokatisë si dhe të shkëmbimit të konsideratave, u zhvillua trajnimi i dedikuar për ndihmën juridike dytësore.

Ky trajnim u zhvillua si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet UNDP, ADA, DhAsh, MD dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Trajnimi u konsultua në 2 sesione gjatë të cilave janë diskutuar tema specifike të ndërlidhura me ofrimin e shërbimit, parë kjo dhe nga këndvështrimi i praktikës.

Sesioni i parë i trajnimit: datat 15-16 Prill 2021.

Gjatë këtij sesioni trajnimi ofruesit e ndihmës juridike dytësore janë trajnuar specifikisht mbi: Legjislacionin mbi ndihmën juridike dhe rëndësinë e tij edhe në nivel ndërkombëtar; Ligjin për ndihmën juridike dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij; Format e shërbimit të ndihmës juridike dhe subjektet përfitues të shërbimit; Standardet e ofrimit të shërbimit në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Diskutime praktike ndërmjet ofruesve të shërbimit, Dhomave të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Sesioni i dytë i trajnimit: datat 22 dhe 22 Prill 2021.

Pas diskutimeve të temave mbi kuadrin ligjor të përgjithshëm mbi ndihmën juridike, sesioni i dytë i trajnimit ju dedikua temave të posaçme të lidhura me kategoritë e veçanta përfituese të ligjit. Me zhvillimin e këtij trajnimi u bë e mundur përmbushja e detyrimit ligjor të trajnimit të detyrueshëm të avokatëve, ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore.

Zhvillimi i Webinareve nga DNJF

Në kuadër të njohjes së ofruesve të shërbimit me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore qoftë sa i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket procedurës së mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit, DNJF ka zhvilluar tre uebinare me qëllim diskutimin më në detaje të akteve nënligjore dhe konkretisht:

1. Webinar me punonjësit e rinj me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në qytetet e Fierit, Dibër, Lezhë dhe Vlorë, (Janar 2021).

Qëllimi kryesor i këtij Uebinari ishte prezantimi i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në terma më konkretë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore.

2. Trajnim i studentëve të angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (Shkurt 2021).

Stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilloi trajnimin me temë “Aksesi në drejtësi dhe risitë e ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga

shteti”, mbajtur me studentët e angazhuar në Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Në këtë takim online u trajtuan temat: “Instrumentët ndërkombëtarë që garantojnë aksesin në drejtësi të qytetarëve ndërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas; Sistemi i ndihmës juridike parësore; Sistemi i ndihmës juridike dytësore; Arritjet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe sfidat për të ardhmes si dhe parashtrimi i rasteve praktike nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë”.

Në fund të këtij aktiviteti studentët u pajisën me një vërtetim pjesëmarrjeje si dhe ju bë me dije mundësia për aplikim në kuadër të praktikave 3 mujore të punës (Prill-Qershor 2021) pranë DNJF si dhe qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;

3.Trajnim online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” (Mars 2021), më datë 18.03.2021.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Eurlius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës. Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës së Shqipërisë.U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

Përgjatë periudhës Janar-Qershor 2021, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që kanë në fokus të tyre mbrojtjen e të drejtave ligjore të qytetarëve është bërë e mundur nënshkrimi i 3 (tre) marrëveshjeve të bashkëpunimit “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe konkretisht:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 13/4 prot., datë 07.01.2021, me Organizatën Drejtësi Sociale;
2. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 1643 prot., datë 27.05.2021, me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër
3. Marrëveshje bashkëpunimi me nr. 498 prot., datë 26.05.2021, me Shoqatën e Invalidëve të Punës.

- **Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mbështetëse**

(UNDP/EURALIUS/OSFA)

1. Bashkëpunimi me UNDP

Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Në mbështetje të Marrëveshjes për zbatimin e projektit, “Shtrirja e shërbimeve të ndihmës ligjore falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” midis Ministrisë së Drejtësisë, UNDP dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), si dhe në zbatim të Letrës së Bashkëpunimit (Korrik 2020-Maj 2022), është bërë e mundur hapja dhe kalimi nën administrim të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas i 8 (tetë) qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në të cilat ushtrojnë funksionet aktualisht 14 (katërbëdhjetë) punonjës me trajnim të posaçëm në qytetin e Durrësit, Fierit, Lezhës, Gjirokastrës, Pogradecit, Dibrës, Shkodrës dhe Vlorës. (informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës).

-Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

Me mbështetjen e UNDP është bërë i mundur zhvillimi i trajnimit të detyrueshëm të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore (informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës).

2. Bashkëpunimi me Euralius

Një ndër partnerët mbështetës të drejtorisë në kuadër të çështjeve të ndihmës juridike falas është EURALIUS, organizatë e cila përgjatë kësaj periudhe është angazhuar në mbështetje të DNJF në zhvillimin e aktiviteteve si vijon:

-Publikimi i Manualit të Ligjit nr.111/2017, dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij

Qëllimi i këtij manuali është të ofrojë një përmbledhje të koncentruar mbi sistemin e ri të ndihmës juridike dhe udhëzime për zbatimin në praktikë të të gjithë kuadrit ligjor në këtë fushë. Ky manual i është shpërndarë të gjitha Gjykatave të Republikës së Shqipërisë, Dhomave Vendore të Avokatisë; Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore; Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve; Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara; Institucioneve të Pavarura si dhe gjendet i publikuar në faqen zyrtare të DNJF.

- Zhvillimi i trajnimeve për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore

Më datë 18.03.2021 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V dhe Shkollën e Magjistraturës zhvilluan trajnimin online mbi ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti” Ky trajnim u zhvillua nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të Euralius dhe të Shkollës së Magjistraturës Në këtë trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, ofruesit e ndihmës juridike parësore, ofruesit e ndihmës juridike dytësore dhe me praninë e veçantë të gjyqtarëve dhe përfaqësues të gjykatave të Republikës

së Shqipërisë. U diskutua mbi një vështrim të përgjithshëm të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe më pas duke u ndalur në terma konkretë dhe raste praktike. Nëpërmjet këtij trajnimi u diskutuan problematikat e hasura nga aktorët kryesorë dhe arrijten e një qëndrimi unifikues në zgjidhjen e tyre.

3. Bashkëpunimi me OSFA

- Ofrimi i ndihmës juridike parësore falas përmes Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë

Përmes projektit: “Ofrimi i ndihmës juridike parësore falas përmes Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore në Tiranë” Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, ka administruar qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore Tiranë; në muajin Prill 2021, me mbështetjen e Fondacionit OSFA. (informacion më i detajuar, gjendet në kreun përkatës).

- Projekt propozimi: “Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabel në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti”

Sikurse rezulton edhe nga eksperiencia e shteteve e ndyshme, është e nevojshme që ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore të ketë një qasje më proaktive me qëllim identifikimin paraprak të kategorive më në nevojë të cilët hasen me problematika ligjore. Si rrjedhojë, përfshirja e paraligjorëve në ofrimin e ndihmës juridike është një mundësi mjaft e mirë sa i përket identifikimit të komuniteteve në nevojë si dhe vendosjes së një lidhje mes institucioneve shtetërore me komunitetin.

Për këtë arsye, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka propozuar pranë OSFA mbështetjen sa i përket projekt-propozimit : “Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabel në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.

Ky projekt ka për synim rekrutimin e 2 paraligjorëve pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore të cilët do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në terren me qëllim evidentimin e komuniteteve (kategori përfituese të ligjit) që kanë nevojë për shërbim ligjor falas si dhe zhvillim e aktiviteteve promovuese/dergjegjëse.

- Objektivi nr. 1: Angazhimi i 2 (dy) paraligjorëve pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë

- Objektivi nr. 2: Trajnimi i paraligjorëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

- Objektivi nr. 3: Krijimi i një rrjeti me paraligjorët e tjerë të angazhuar pranë Organizatave Jofitimprurëse me fokus bashkëpunimin në referimin e rasteve dhe zgjidhjen e problemeve.

Nga ana e Fondacionit OSFA jemi bërë me dije mbi miratimin e këtij projekt-propozimi dhe do të procedohet me nënshkrimin e kontratës së grantit në muajin

Korrik 2021.

Masa prioritare 2: Procedura e ndërmjetësimit si një mekanizëm zgjidhjeje alternative, funksionale në praktikë jo vetëm në ligj, është efiçase dhe çështjet zgjidhen me pëlqim dhe marrëveshje të plotë të palëve.

- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve si një mekanizëm alternative për qytetarët për zgjidhjen e problemeve ligjore ka forcuar bashkëpunimin ndërinstytucional me Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve përmes organizimit të trajnimeve fillestare dhe vazhduese. Në këtë kuadër janë përcaktuar dhe miratuar rregulloret mbi trajnimet dhe metodat e provimit për testimin e kandidatëve ndërmjetës; Urdhri Nr.89, datë 23.02.2021 “Për miratimin e rregullores së trajnimit fillestar dhe vazhdues, për zgjedhjen e trajnerëve, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së tyre”, si dhe Urdhër Nr.90, datë 23.02.2021 “Për miratimin e rregullores së provimit të kualifikimit për profesionin e ndërmjetësit”. Në zbatim të këtij urdhëri ka filluar trajnimin fillestar, 1 vjekar me 60 kredite, me 97 kandidatë, i cili përfundon në maj 2022, bazuar një Programi e Moduli të miratuar nga Ministri i Drejtësisë. (Publikuar në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve). Gjithashtu është zhvilluar trajnimi i vazhduar për Anëtarët e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, në zbatim të Kodit për të Mitur dhe Ndërmjetësit për mosmarrëveshjet e punës. U ngrit një grup për trajnimin Trajnerëve, i cili mbetet si aset i DHKN-së, sipas Kurikulave Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
- Në kuadër të fushatave ndërgjegjësuese, që Shërbimi i Ndërmjetësimit të ketë një përfshirje në të gjithë territorin e Shqipërisë, janë realizuar takime të shumta, janë shpërndarë fletëpalosje në të gjithë Shqipërinë dhe Hand Book, ku shpjegohet mënyra e kontaktit të Ndërmjetësve dhe Llojet e Mosmarrëveshjeve që zhgjidhen me Ndërmjetësim. Janë vendosur Tabela në cdo gjykatë në rrethe, dhe fletëpalosje nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve. Nga bashkëpunimet në OJF, janë hapur 2 zyra Tiranë e Durrës për fushatë informimi (DHKN&MD&CSSP) duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, duke dhënë shërbim falas nëpërmjet ALTRI-t , pranë Gjykatave Shkodër, Pogradec, Tiranë e Durrës . Një rol të madh në ndërgjegjësim, ka luajtur Media on-line dhe e shkruar, ku janë realizuar marrëveshje me shumë TV, duke dhënë shumë informacion me artikuj shkencor, në emisione televizive & informative dhe shkrimeve të shumta në gazeta.

- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, ka vijuar takimet me Partnerët e Projektit; Ministrinë e Drejtësisë, CSSP dhe AFCR në kuadër të procesit të krijimit të një bazë elektronike të të dhënave me qëllim regjistrimin e çdo ndërmjetësi që do të ushtrojë këtë aktivitet. Regjistri është në momentet e finalizimit, ku nga shtatori do të trajnohen dhe ndërmjetësit, mbi mënyrën e regjistrimit tëçështjeve, që një qytetar, nëpërmjet on-line të zgjedhë ndërmjetësimin më të përgatitur dhe që ka zgjidhur sa më shumëçështje. Ky Database do ketë 3 platforma:
 1. Nga administratori i cili do të manaxhoje të gjithë Regjistrin, pra gjithë mënyrën e regjistrimit dhe korrigjimit.
 2. Ndërmjetësit që do të hedhin gjithëçështjet e tyre në këtë sistem.
 3. Qytetarët do të kenë akses vetëm sipas qyteteve, sipas moshave apo çështjeve, ndërmjetësimin më me eksperiencë në treg.

Indikatorët të cilat konsiderohen të sukseseshëm për periudhën e raportimit:

- Themelohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Drejtoria ka një staf me kapacitet të mjaftueshëm për të garantuar aftësinë dhe për të ofruar shërbimet e kërkuara nga qytetarët:
 - Uebfaqja zyrtare www.ndihmajuridike.gov.al
 - juridiksioni.al
 - numri jeshil 0801010
- Realizuar moduli i parë të trajnimit të detyrueshëm të punonjësve të Qendrave Primare të Ndhmës Ligjore.
- Përcaktohen rregulloret dhe programi mësimor për trajnimin dhe metodat e provimit për testimin e kandidatëve për ndërmjetësim. (Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve)
- Projektimi i bazave të të dhënave elektronike. (Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësuesve).

Angazhimi 7

Masa Prioritare 1: Rritja e kapaciteteve teknike dhe profesionale të Ministrisë së Drejtësisë për të pasur një faqe interneti plotësisht operative, në menyrë që informacioni të publikohet në kohë reale dhe është i dobishëm për qytetarët kur ata te kërkojnë shërbime.

Pranë Ministrisë së Drejtësisë u krijua grupi i punës me qëllim evidentimin e dokumenteve dhe proceseve të cilat duhet të publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë me informacion të kuptueshëm për qytetarët dhe në përmbushje të aksesit në informacion.

Në këtë kuadër, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me përfaqësuesit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit ka krijuar një grup pune në lidhje me përditësimin e faqes në internet www.drejtesia.gov.al. Uebfaqja e re e krijuar do të lehtësojë qasjen në dokumentet zyrtare për qytetarët duke shkurtuar kohën e marrjes së informacionit dhe duke pasur mundësinë të informohen në kohë reale për të gjitha çështjet me kërkesë të secilit grup të interesit, duke sjellë risi dhe një ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtën e informacionit dhe transparencës për të gjithë qytetarët ose grupet e interesit. Në faqen zyrtare të MD-së u realizua kategorizimi i posaçëm mbi çdo dokument politikash në 4 nën seksione ku përfshihet;

1. Baza ligjore e çdo strategjie,
2. Raportet e Monitorimit të Strategjisë përkatëse në gjuhën shqipe
3. Raportet e Monitorimit të Strategjisë përkatëse në gjuhën angleze
4. Njoftime

Masa Prioritare 2: Rritja e transparencës dhe përmirësimi i aksesit të informacionit publik

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit referuar strategjisë dhe planit të saj përkatës (përmendur këtu; raportet 6 mujore dhe vjetore të Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur, Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut etj) Ministria e Drejtësisë dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe e publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe Raporti i miratuar i monitorimit publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë. Faqja e internetit të Ministrisë do të vijojë të përditësohet me të gjitha raportet e monitorimit, kontributet dhe informacionet përkatëse për pjesëmarrjen efektive dhe duke informuar palët e interesuara. Gjithashtu, faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë në rrjete sociale është e vendosur në dispozicion të publikut duke e përditësuar në mënyrë aktive me njoftimet përkatëse në kuadër të transparencës dhe ofrimit të informacionit të nevojshëm.

Faqja zyrtare Web e Ministrisë së Drejtësisë: <https://www.drejtesia.gov.al/>

Faqja zyrtare në Facebook: Ministria e Drejtësisë

Faqja zyrtare në Instagram: ministria_drejtesia

	<p>Indikatorët të cilat konsiderohen të sukseseshëm për periudhën e raportimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Uebfaqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë është azhurnuar plotësisht. • Publikimi i strategjive, raportet e monitorimit në faqen zyrtare të MD. Publikimi i përmbledhjeve të raporteve të ndryshme në gjuhë të thjeshtuar dhe të kuptueshme. • Kriteret për sistemin e zgjedhur të raportimit me komente nga ekspertët/konsultat e jashtme. Sistemi i raportimit i aprovuar dhe integruar në Ministrinë e Drejtësisë dhe të gjitha procedurat e institucioneve vartëse.
<p>Përse është ky angazhim relevant me vlerat e Qeverisjes së Hapur/OGP?</p>	<p>Komponenti numër III është relevant me vlerat e Qeverisjes së Hapur/OGP pasi është konform katër parimeve të OGPTë cilat janë:</p> <p><u>Transparenca & Qasja në Informacion</u></p> <p>Parimi kryesor i transparencës synon qasjen e qytetarëve në informacion dhe publikimin e tij në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë.</p> <p>Informimi është niveli bazë ku hidhen themelet e bashkëpunimit mes institucioneve qeverisëse dhe qytetarëve. Në këtë kuadër të gjitha informacionet të gjitha dokumentet dhe të dhënat përkatëse si takimet konsultative të zhvilluara, konsultimi i draft dokumenteve janë lehtësisht të aksesueshme dhe të disponueshme.</p> <p><u>Llogaridhënia publike</u></p> <p>Terësia e masave dhe parashikimeve të këtij plani veprimi janë vënë me qëllimin për të forcuar përgjegjshmërinë e organeve dhe për të përforcuar qasjen e qytetarëve në drejtësi me procese sa më pak burrokratike. Standartizimi dhe bërja e më shumë informacionit publik, e bën qeverinë më transparent tek qytetarët dhe rrit përgjegjshmërinë në vendimarrje.</p> <p><u>Pjesëmarrja Publike & Qytetare</u></p> <p>Përfshirja e palëve të interesuara në kuadër tëpërmirësimit të iniciativave</p>

	<p>të publikut drejt proceseve të bashkë-krijimit të planit të veprimit 2020-2022 ka qënë një ndër synimet kryesore.</p> <p><u>Teknologji & Inovacion</u></p> <p>Teknologjitë e reja kanë qëllim shpërndarjen e informacionit publik, pjesëmarrjen e grupeve të interesit si dhe bashkëpunimin e tyre në kuadër të proceseve gjithëpërfshirëse. Web faqja e Ministrisë së Drejtësisë ka si synim përcjelljen tek publiku të informacionit të qartë dhe të dobishëm.</p>			
Informacion shtesë	<p>Akresi në Drejtësi, Llogaridhënia dhe Transparenca konsiderohen komponentë me përparësi jo vetëm nën kuadrin e OGP, por edhe për programet e reformve ndërsektoriale sic është Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë. Strategjia e miratuar në vitin 2016 si dhe plani i saj i veprimit me VKM Nr. 409, datë 19.6.2019 “Për miratimin e Planit e Veprimit 2019-2021 të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë”.</p> <p>Gjithashtu, pas përfundimit të fazës së parë të reformës në drejtësi, e zyrtarizuar me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2016-2020 (SND I), në shkurt të vitit 2020 filloi puna për rishikimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për vitet e ardhshme 2021-2025 e cila mban në konsideratë në përmbajtjen e saj elementët kryesorë të OGP. Vizioni i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 21-25: “Sistem i drejtësisë i pavarur, llogaridhënës, i aksesueshëm, transparent dhe eficient që mbron të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane”.</p>			
Niveli i realizimit	Nuk ka filluar	Limituar	Konsiderueshem	Perfunduar
			X	
Përshkrimi i rezultateve	Referojuni Aktivitetet/milestone dhe ‘Si do të kontribuojë angazhimi për të zgjidhur problematikën përkatëse?’			
Hapat e tjere	Aktivitetet e planifikuara janë zbatuar për periudhën përkatëse dhe po bëhen përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar më shumë transparencën në lidhje me cilësinë dhe thjeshtimin e informacionit që publikohet për këtë arsye akresi në drejtësi është një angazhim që përfshihet në Planin e Ri të Veprimit të OGP për 2020-2022.			
Aktivitetet/milestone në raport me produktet e verifikueshme	Fillimi	Përfundimi	Niveli i realizimit	
<p>Angazhimi 6 Masa prioritare 1</p> <p>Ndihma juridike ofrohet në një formë efikase dhe efektive e cila u siguron qytetarëve në nevojë, qasje të plotë në një shërbim të tillë</p>				

Pika referimit 1: Sistemi primar dhe sekondar i ndihmës juridike është plotësisht funksional dhe siguron qasje të barabartë në drejtësi për qytetarët në të gjithë vendin (burimet njerëzore, zyrat e ndihmës juridike primare dhe mjetet e duhura, kapaciteti teknik, etj.).	1 Janar 2020	31 Dhjetor 2021	Përfunduar
Pika referimit 2: Forcimi dhe ndërtimi i kapaciteteve përmes trajnimit të duhur për ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike falas në të gjithë vendin.	1 Janar 2020	31 Dhjetor 2021	Përfunduar
Pika referimit 3: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe institucioneve publike, si dhe me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare/organizatat e shoqërisë civile.	1 Korrik 2021	31 Dhjetor 2021	Përfunduar
Pika referimit 4: Krijimi i Forumit Ndërinstitucional për ndihmën juridike të garantuar nga shteti me sekretarinë teknike në Drejtorinë e Ndihmës Ligjore Falas.	1 Janar 2021	12 Dhjetor 2022	Limituar
Masa prioritare 2			
Procedura e ndërmjetësimit si një mekanizëm zgjidhjeje alternative, funksionale në praktikë jo vetëm në ligj, është efikase dhe çështjet zgjidhen me pëlqimin dhe marrëveshjen e plotë të palëve.			
Pika referimit 5: Rritja e bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN).	1 Janar 2021	12 Dhjetor 2022	Përfunduar
Pika referimit 6: Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve përmes organizimit të trajnimeve fillestare të vazhdueshme, si dhe trajnimeve të trajnuesve.	1 Janar 2020	31 Dhjetor 2021	Proces
Pika referimit 7: Organizimi i fushatave sensibilizuese për shërbimin e ndërmjetësimit në vend.	1 Janar 2020	31 Dhjetor 2021	Përfunduar
Pika referimit 8: Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve do të krijojë një bazë elektronike të të dhënave në mënyrë që të regjistrojë çdo ndërmjetës që ushtron aktivitetin e tij në këtë fushë, gjithashtu aksesin të çdo qytetari të interesuar por edhe transparencën.	1 Janar 2021	31 Dhjetor 2021	Proces
Angazhimi 7			
Masa prioritare 1			
Rritja e kapaciteteve teknike dhe profesionale të Ministrisë së Drejtësisë për të pasur një faqe në internet plotësisht funksionale, kështu që informacioni të publikohet në kohë reale dhe informacioni të jetë i dobishëm për qytetarët kur kërkojnë shërbime			
Pika referimi 1: Krijimi i një grupi pune në Ministrinë e Drejtësisë (MD) në mënyrë që të identifikojë dokumentet dhe proceset që duhet të publikohen dhe si t'i bëjë këto më të arritshme (gjuhë jo-teknike,	1 Korrik 2020	31 Dhjetor 2020	Përfunduar

diagrama, koncepte të thjeshtuara).				
Pika Referimit 2: Analiza dhe hartimi i raportit mbi gjendjen aktuale të faqes së internetit në të cilën do të nxjerrë në pah informacionin e nevojshëm për të përmirësuar qasjen në informacion për publikun		1 Korrik 2020	31 Dhjetor 2020	Përfunduar
Pika Referimit 3: Faqja zyrtare e MD dhe institucioneve vartëse plotësisht funksionale dhe e arritshme me informacion të detajuar dhe të plotë të botuar.		1 Janar 2021	31 Dhjetor 2021	Përfunduar
Masa prioritare 2:				
Rritja e transparencës dhe përdorimit të aksesit në informacionin në publik				
Pika Referimit 4: Transparencë e shtuar në bërjen publike të raportimit të strategjive dhe zbatimit të planeve të tyre të veprimit, si dhe aktiviteteve gjithëpërfshirëse të institucionit.		1 Janar 2020	31 Dhjetor 2022	Përfunduar
Pika Referimit 5: Komunikimi audioviziv i veprimtarisë së institucionit si një mjet i rritjes së transparencës së shtuar (daljet televizive të Ministrisë, fushata ndërgjegjësimi, aktivitete sensibilizuese etj).		1 Janar 2020	31 Dhjetor 2022	Përfunduar
Masa prioritare 3:				
Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve dhe përgjegjëseve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të vartësisë, të cilat do të kenë një ndikim pozitiv në transparencën dhe llogaridhënien, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, inspektimet e kryera nga Ministria e Drejtësisë për institucionet respektive				
Pika referimit 6: Miratimi i manualeve, udhëzimeve, rregullave të brendshme përkatëse për funksionimin më efikas të institucionit.		1 Janar 2021	30 Korrik 2021	Proces
Pika Referimit 7: Miratimi i një sistemi efikas raportimi të detyrave dhe përgjegjëseve të secilit institucion në përputhje me transparencën dhe llogaridhënien.		1 Janar 2021	30 Korrik 2021	Përfunduar
Informacion kontakti				
Emri i personit përgjegjës nga institucioni drejtues		Elona Hoxha		
Titulli, Departamenti		Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë		
E-mail dhe telefon		elona.hoxha@drejtesia.gov.al		
Aktorë të tjerë të përfshirë	Aktorë të tjerë të përfshirë	Agjenci të tjera Qeveritare të Përfshira: Institucione në varësi të Ministrisë së Drejtësisë (Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas); Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve,		
	Grupe	Agjenci të tjera jo-qeveritare: Organizata të shoqërisë civile,		

Komponenti 4: Qeverisja Fiskale dhe transparenca buxhetore

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qeveria shqiptare ka vazhduar të punojë me synim sigurimin e një progresi të kënaqshëm në lidhje me disponueshmërinë publike të një informacioni buxhetor të arritshëm, në kohë, gjithëpërfshirës. Kjo është një punë e vazhdueshme që është materializuar në programe të ndryshme të politikave shqiptare, siç janë dokumenti strategjik, dmth. Strategjia e MFP-së, planet e veprimit, si Plani i veprimit i OGP-së, dokumentet vjetore të veprimit të IPA-s, etj. Rezultatet pritet të hapin qeverinë në termat e transparencës së qeverisë.

Gjatë vitit 2020 është arritur një progress i mire dhe të gjithë targetet e rezultateve të performancës janë përbushur. Targeti i treguesit “Llogaritë Kombëtare të Qeverisë” u përbush 75%. Është arritur treguesi “Deklaratë e përmirësuar e riskut fiskal”. Bazuar në targetet e 2020 (+4 ndërmarrje shtetërore të tjera), Njësia e Riskut Fiskal, ka mbledhur të dhëna financiare nga UKT, Hekurudha Shqiptare, Posta Shqiptare, Albgaz dhe po analizon dhe përgatit analizën financiare përkatëse. Target i vitit fiskal 2020 për treguesin *Publikimi raporteve financiare që përmbajnë informacion të arritshëm financiar dhe jo-financiar të performancës* është arritur. U implementuan plotësisht formatet e reja për Raportin Vjetor të Ekzekutimit të Buxhetit dhe raportit brenda vitit.

Është arritur progres dhe në forcimin e mëtejshëm të sistemeve dhe kapaciteteve për përgatitjen e statistikave financiare të qeverisë në përputhje me standartet kombëtare. Gjatë vitit 2020 u botua nga INSTAT një dokument² i rëndësishëm që synon të përmirësojë respektimin e parimit të dyfishtë të përafrimit midis fushave statistikore në nivel kombëtar dhe shtrirjes së koordinuar midis vendeve në nivelin e BE-së.

Transparenca fiskale e Shqipërisë u përmirësua në Sondazhin e Buxhetit të Hapur të vitit 2019 pasi ka publikuar edhe raportin në mes të vitit në internet. Gjatë vitit 2020 u zhvilluan seanca trajnimi në vendin e punës me menaxherët e programit dhe Departamentet e Financave të dy Ministrive të Linjës, me qëllim përmirësimin e formatit të raportit vjetor dhe brenda vitit të ekzekutimit të buxhetit. Në vitin 2020 u zhvillua dhe u botua një Udhëzues i Buxhetit të Qytetarëve. Për më tepër, një kalendar i dëgjimit të buxhetit me proceset kyçe të buxhetit u përgatit dhe u zbatuar. OShC-të u trajnuan online në vitin 2020 për të rritur kapacitetet e tyre për të kuptuar ciklin e buxhetit.

²Politikat e Rishikimit të Harmonizuara për Statistikat Makroekonomike

Vazhdimi i anëtarësimit në OGP dhe në veçanti prioriteti aktual mbi transparencën e buxhetit, do të vazhdojë me synimin për të përmirësuar transparencën dhe për të arritur një qeveri plotësisht të hapur.

ANGAZHIMET	
ANGAZHIMI SPECIFIK	
KOMPONENTI4: ANGAZHIMI8	
Qeveria e Hapur me qëllim rritjen e transparencës fiskale për të përmirësuar mbulimin, cilësinë dhe aksesin e informacionit mbi financat publike.	
PERIUDHA E IMPLEMENTIMIT: 2020-222	
Institucioni udhëheqës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PERSHKRIMI I ANGAZHIMIT	
Cila është problematika dhe çfarë do të adresojë angazhimi respektiv?	<p>Transparenca, pjesëmarrja e publikut dhe mbikëqyrja legislative në zhvillimin e buxheteve krijon rezultate më të mira dhe janë çështjet kryesore për të përmirësuar më mirë aksesin e qytetarëve në dokumentet fiskale. Rritja e përgjegjësisë mbi buxhetin dhe ciklin fiskal parandalon humbjet dhe korrupsionin dhe siguron që vendimet dhe shpenzimet buxhetore pasqyrojnë interesat e qytetarëve. Përmes transparencës, pjesëmarrjes së publikut dhe mbikëqyrjes legislative, kjo mund të ndihmojë në luftimin e korrupsionit. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut përgjatë buxhetit dhe ciklit fiskal është veçanërisht e rëndësishme për Shqipërinë. Një dokument i rëndësishëm³ që synon të përmirësojë respektimin e parimit të dyfishtë të përafrimit midis fushave statistikore në nivel kombëtar dhe shtrirjes së koordinuar midis vendeve në nivelin e BE u botua nga INSTAT gjatë vitit 2020. Në vitet e fundit, transparenca fiskale është rritur në Shqipëri. Midis 2010 dhe 2019 rezultati i Shqipërisë në Indeksin e Buxhetit të Hapur⁴ (OBI) është rritur nga 33 në 55 nga 100 të mundshëm. Megjithatë inkurajues, sipas vlerësimit të OBI 2019, paraqet se Shqipëria ka bërë progress por ende nuk boton material të mjaftueshëm për të mbështetur debatin e informuar publik mbi buxhetin⁵. Në vlerësimin e vitit 2019 të disponueshmërisë në internet, afatet kohore dhe gjithëpërfshirjen e tetë dokumenteve kryesore buxhetore, Shqipëria u rendit e 43-ta nga 117 vende.</p>

³Harmonized Revision Policy for Macroeconomic Statistics

